

KËRKIME GJUHËSORE

Almira SADIKAJ

VEÇORI SEMANTIKE TË MBIEMRAVE PREJFOLJORË ME –SHËM NË VEPRËN *FJALORI I GJUHËS SHQIPE 2006*

Abstrakt: Në këtë punim synohet të vihen në dukje veçoritë semantike të mbiemrave prejfoljorë me prapashtesën –shëm. Mbiemrat prejpjesorë kanë aftësinë për të shënuar tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja që përbën temën fjalëformuese të tyre. Për tipin e mbiemrave të përfutur nga pjesorja, nyjet janë pjesëza me funksion fjalëformues dhe fjalëndryshues, me anën e tyre pjesorja kalon në mbiemër prejpjesor.

Në veprën “Fjalori i Gjuhës Shqipe 2006” mbiemrat prejpjesorë na paraqiten me dy ndarje: në mbiemra me kuptim pësor dhe mbiemra me kuptim vepror. Mbiemrat me kuptim pësor janë të shumtë, ata formohen prej foljesh të parme ose të prejardhura duke iu bashkangjitur prapashtesa të ndryshme, kështu mund të përmendim: *i çarë, i hapur, i lexuar, i mësuar, i punuar, i qëruar, etj*, ndërsa me prapashtesën –shëm që në gjuhën shqipe mund të them se është një ndër prapashtesat prodhimtare, pjesa më e madhe e mbiemrave të formuar me këtë prapashtesë kanë kuptim vepror, si: *i adoptueshëm, i bindshëm, i dallueshëm, i motivueshëm, i gabueshëm, i gëzueshëm, i zgjidhshëm, etj*. Po kështu kemi edhe formime mbiemërore prej foljeve të tilla: *afroj – afrues - i afrueshëm - i afruar, punoj - punues - i punueshëm - i punuar etj*.

Kohët e fundit ka dalë nga shtypi *Fjalori i Gjuhës Shqipe* (2006), i hartuar nga gjuhëtarë dhe leksikografë, si: Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Thanasi Feka, Valter Memisha dhe Artan Goga, botim i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Ky fjalor pasqyron fjalët e gjuhës shqipe si një mjet i domosdoshëm dhe i përdorshëm në radhë të parë nga pedagogët, mësuesit, studentët, nxënësit e shkollave të mesme e të klasave të larta të shkollave 9 - vjeçare, si edhe nga shkrimtarët, publicistët, përkthyesit, nga të gjithë ata që merren me shqipen ose e mësojnë atë.

Si objekt studimi në këtë konferencë kam menduar të trajtoj temën: *Veçori semantike të mbiemrave prejfoljorë me - shëm në veprën “Fjalori i Gjuhës Shqipe 2006”*.

Mbiemri është një nga klasat më të pasura leksiko - gramatikore të gjuhës shqipe, që paraqet një fushë të gjerë studimi për këdo, për gjuhëtarin e për mësuesin, për studiuesin e për dashamirësin e gjuhës. Në “Gramatikën e gjuhës shqipe, 1” (botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) shkruhet se: “*Mbiemër quhet ajo pjesë e ligjëratës që emërton një tipar (cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, në numër e për një pjesë edhe në rasë me emrin e këtij sendi*”¹.

¹ A. Dhrimo, *Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe*, në “Çështje të gramatikës së gjuhës shqipe”. II, Tiranë, 1975, f. 141.

Kurse prof. Ali Dhrimo thekson se: “Mbiemri, ashtu si edhe emri që përcaktohet prej tij, është një fjalë emërtuese dhe e kuptimshme, që mund të kryejë funksione të ndryshme si gjymtyrë e fjalisë dhe që ka po ato kategori gramatikore që ka edhe emri që ky përcakton”. Shaban Demiraj shprehet se “mbiemrat e shprehin përshtatjen e tyre me emrat në gjini, në numër dhe në rasë me anë të nyjave të përparme a me anë të mbaresave”².

Në “Gramatikën e gjuhës shqipe”, 1, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mbiemrat klasifikohen në bazë të kritereve:

1. sipas kuptimit të tyre leksikor;
2. sipas veçorive të tyre morfologjike.

1. *Klasifikimi sipas kuptimit leksikor*: Duke u nisur nga tipari që ata emërtojnë, mbiemrat ndahen në:

A) Mbiemra cilësorë (mal *i lartë*). Këta mbiemra shprehin a emërtojnë veti a cilësi të cilat rroken drejtpërsëdrejti me shqisa ose që janë vetëm të mendueshme.

B) Mbiemra marrëdhëniorë (dashuri *atërore*). Këta mbiemra e japin tiparin e sendit nëpërmjet emërimit të marrëdhënies të këtij sendi me një send tjetër ose me një rrethanë a një veprim.

2. *Klasifikimi sipas veçorive morfologjike*. Një nga tiparet kryesore të mbiemrit në gjuhën shqipe është nyjëzimi.

* Nyjëzimi është një proces tepër i hershëm në gjuhën shqipe por dhe veprues në ditët e sotme. Nyja është modifikuesi kategorial, gramatikor, ndërsa si modifikues kuptimor është tërë struktura e fjalës, e cila është e specializuar sipas kategorisë leksiko-gramatikore të mbiemrave të nyjshëm, dhe në këtë rast të mbiemrave prejpjesorë me paranyjëzim në gjuhën shqipe. Nyja shërben në radhë të parë si formant fjalëformues, dhe së dyti si mjet shprehës i kategorisë gramatikore të rasës, gjinisë dhe të numrit të mbiemrat, pra ka funksion të dyfishtë. Sipas kësaj veçorie mbiemrat e shqipes ndahen në dy grupe:

A) *Mbiemra të nyjshëm*. Te këta mbiemra nyja është bërë pjesë e domosdoshme e tyre. Nyjëzimi tek mbiemrat karakterizohet nga nyjet e paravendosura *ie*, të cilat janë të përgjithshme për çdo mbiemër, në këtë rast për mbiemrat prejpjesorë (prejfoljorë) p.sh: *hap – i hapur, vesh – i veshur, fle – i fjetur, laj – i larë* ose *admiroj – i admirueshëm, akuzoj – i akuzueshëm, lexoj – i lexueshëm*, etj.

B) *Mbiemra të panyjshëm*. Këta futen mbiemrat që formohen me konversion nga emrat përgjegjës, p.sh., *dibran, vlonjat*, etj; gjithë mbiemrat me kuptim përkatësor të formuar me prapashtesat *-ar, -tar, -ik, -ist, -iv, -or, -tor* etj; me prapashtesën *-ues* dhe *-(ë)s*. Dukurinë e dysisë strukturore të mbiemrave të nyjshëm dhe të panyjshëm Shaban Demiraj e lidh me evolucionin e vetë gjuhës shqipe. Ai në Gramatikën e gjuhës shqipe, thekson se “*Çështja e zanafillës së funksionit të nyjës së përparme të mbiemrit mund të sqarohet ose duke pranuar tezën sipas së cilës ajo ka pasur në fillim funksion caktues, ose duke e pranuar*

² Sh. Demiraj, Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe, Tiranë, 1972, f. 262.

VEÇORI SEMANTIKE TË MBIEMRAVE PREJFOLJORË ME –SHËM NË
VEPRËN FJALORI I GJUHËS SHQIPE 2006

tezën, sipas së cilës paranyjëzimi i mbiemrave u përftua nga nevoja për të rishprehur gjuhësisht përshtatjen e tij me emrin, në një kohë kur mbaresat e tij nuk e kryenin më në mënyrë të plotë këtë funksion”³.

* Nyjat e përparme të mbiemrave përbëjnë një veçori tipike të morfologjisë shqipe, ato ndryshojnë nga nyjet shquese, pasi nuk kanë të bëjnë aspak me kategorinë gramatikore të shquarsisë e të pashquarsisë. Për tipin e mbiemrave të përftuar nga pjesorja, nyjet janë pjesëza me funksion fjalëformues dhe fjalëndryshues, me anën e tyre pjesorja kalon në mbiemër prejpjesor. Kështu kemi mbiemra të formuar nga:

a) *tema e shkurtuar e pjesores (pa –ur dhe –r(ë)).* Kjo shërben si temë prodhuese për mbiemrat e prejardhur nga pjesoret e foljeve me temë në bashkëtingëllore dhe të foljeve me temë në: –i, –e dhe –ye, p.sh.: *i ardhshëm, i bëshëm, i çuditshëm, i djegshëm, i falshëm, i dhimbshëm, i kapshëm, i pishëm, i shkëlqyeshëm* etj.

b) *tema e foljeve.* Edhe në këto formime del po ai problem që shqyrtuam te formimet prejfoljore me prapashtesën – (ë)s. Ky nëntip e ka zanafillën e vet nga gegërishtja, ku mbiemri ka si temë prodhuese pjesoren e dialektit verior (*punue – i punueshëm*). Për foljet me temë në –o, pranohet ai formim mbiemrash të cilët zbërthehen në -ue dhe prapashtesën –shëm, p.sh.: *i çmueshëm, i avullueshëm, i dëshirueshëm, i trishtueshëm* etj, ndërsa për foljet me temë në –ua pranohet alternimi i grupit zanor –ua në –ue, p.sh.: *shkruaj – i shkrueshëm, bluaj – i blueshëm* etj.⁴

Mbiemra prejpjesorë të nyjshëm janë të gjithë mbiemrat e formuar nga paranyjëzimi i pjesores pa ndonjë prapashtesë: *i lexuar, i shkruar, i hapur, i zënë* etj, ose të gjithë mbiemrat që formohen nga nyjëzimi e përngjitja e togut *pa + pjesore*, si: *i pavendosur, i paqëndrueshëm* etj, ndërsa mbiemra të panyjshëm janë të gjithë mbiemrat e prejardhur nga pjesorja ose nga e tashmja e foljes me prapashtesën –ues dhe –(ë)s: *bombardues, shkatërrues, goditës, qortues* etj, si dhe të gjithë mbiemrat e përbërë nga një emër + pjesore, si: *buzëplasur, dritëshuar* etj, si dhe të gjithë mbiemrat e prejardhur të formuar me paranyjëzim duke marrë dhe prapashtesa si: –ë, –të, –m, –(ë)s, –shëm, etj.

Na del se prej foljesh kemi formime mbiemërore tridrejtimëshe: 1) formimi i mbiemrave me –ës të tregojnë marrëdhëniet e sendit të dhënë ndaj një veprimi nga folja dhe mbartin tiparin e vepruesit; 2) formimi i mbiemrave me prapashtesën –shëm që në përgjithësi tregojnë aftësinë a mundësinë e sendit të karakterizuar nga mbiemri i dhënë për të kryer veprimin e emërtuar nga tema fjalëformuese folje; 3) formimi i mbiemrave prejpjesorë që në përgjithësi kanë kuptim pësor dhe tregojnë rezultatin e veprimit të shprehur nga folja. Nisur nga formimet tridrejtimëshe mbiemërore mund të themi se: Mbiemrat prejpjesorë emërtojnë tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja që përbën temën

³ Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 61.

⁴ A. Dhrimo. Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe. S.F, 1972 /3, f. 68-70.

fjalëformuese. Struktura morfologjike e mbiemrave prejppjesorë, është dybërthamshme e tipit *nyjë e përparme + temë e pjesores*, që do të thotë se këto njësi janë të analizueshme, të zbërthyeshme si nga ana ndërtimore, ashtu dhe nga ajo kuptimore. Këta mbiemra do të futen në nëngrupin e derivateve leksiko-gramatikore, që përfshin formimet me ndajshesa e pa ndajshesa dhe me ndryshim të kategorisë leksiko - gramatikore⁵.

Studiuesi V. Memisha, thekson se *nyje e përparme + pjesorje e foljes* krijon një model tematik fjalëformues të veçantë, por jo të panjohur për tema të tjera fjalëformuese. Ky strukturim u kundërvihet gjedheve të tjera fjalëformuese të shqipes, duke mbartur tipare që përcaktojnë se mbiemrat prejppjesorë janë krijuar në përputhje me ligjet e zhvillimit të gjuhës sonë. Kështu do të kishim *afroj-afrues- i afrueshëm- i afruar, punoj- punues- i punueshëm- i punuar* etj. Këto formime tregojnë se një varg i tërë mjetesh të fjalëformimit ndajshesor janë specializuar e po specializohen në rrafshin semantik e stilistikor. Kjo dukuri është e pranishme e vepruese dhe një nga arsyet është aftësia e mundësia që kanë vetë temat fjalëformuese për tu lidhur me njësi të tjera të gjuhës në një rrafsh më të gjerë sesa rrafshi fjalëformues, pra në atë gramatikor.

Në veprën “Fjalori i Gjuhës Shqipe 2006” mbiemrat prejppjesorë na paraqiten me dy ndarje: në mbiemra me kuptim pësor dhe mbiemra me kuptim vepror. Mbiemrat me kuptim pësor janë të shumtë, ata formohen prej foljesh të parme ose të prejardhura duke iu bashkangjitur prapashtesa të ndryshme, kështu mund të përmendim: *i çarë, i hapur, i lexuar, i mësuar, i punuar, i qëruar, i zgjedhurar, i zhvilluar* apo dhe me prapashtesën *-shëm* që në gjuhën shqipe mund të them se është një ndër prapashtesat prodhimtare, dhe siç thekson dhe A. Dhrimo pjesa më e madhe e mbiemrave të formuar me këtë prapashtesë kanë kuptim vepror, si: *i adoptueshëm, i bindshëm, i dallueshëm, i motivueshëm, i mëshirshëm, i gabueshëm, i gëzueshëm, i zgjidhshëm*, etj. Po kështu kemi edhe formime mbiemërore prej foljeve të tilla: *afroj – afrues - i afrueshëm - i afruar, punoj - punues - i punueshëm - i punuar*, etj. Kjo dukuri është e pranishme e vepruese dhe një nga arsyet është aftësia e mundësia që kanë vetë temat fjalëformuese për tu lidhur me njësi të tjera të gjuhës në një rrafsh më të gjerë sesa rrafshi fjalëformues, pra në atë gramatikor. Mund të themi se jo të gjitha foljet e kanë aftësinë e krijimit të këtyre vargjeve mbiemërore.

Sipas B. Bokshit prapashtesa *-shëm* del në të gjitha të folmet toske, duke përfshirë edhe ato të diasporës. Mbiemrat prejfoljorë me *-shëm* ndërtohen mbi tre tipat e shënuar të temës. Si e tillë ajo është paradigmatisht me prapashtesën *-ës* dhe me prapashtesat e tjera: *-r, (-ur, -rë), -m, -n, -t(ë)* të mbiemrave të nyjshëm. Mbiemrat me *-shëm* nuk janë formuar mbi formën e shkurtuar të kësaj pjesoreje, por mbi temën foljore mbi të cilat janë shtuar gjithë prapashtesat e mbiemrave të nyjshëm prejfoljorë: *i mbjellt - i mbjellur - i mbjellun - i mbjellshëm / i haptë - i hapur - i hapun - i hapshëm / i pitë - i pim - i pirë - i pin - i pishëm / i thyet - i thyer - i thyem - i thy(e)n - i thyeshëm* etj.

⁵ J. Thomai, Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gj. shqipe, S.F, 3, 1983, f. 54.

VEÇORI SEMANTIKE TË MBIEMRAVE PREJFOLJORË ME –SHËM NË
VEPRËN FJALORI I GJUHËS SHQIPE 2006

Të gjitha këto prapashtesa formojnë mbiemra prejppjesorë, por mund të themi se mbiemrat e formuar me prapashtesën –*të* dallohen për nga kuptimi jo vetëm nga prapashtesa –*shëm* por edhe nga mbiemrat me prapashtesat e tjera, me anë të së cilës na vërtetojnë se prapashtesa –*të* nuk formonte pjesore në gjuhën shqipe, por e kishte origjinën nga greqishtja dhe kryesisht nga mbiemrat me –*to*.⁶

A. Dhrimo pohon se prapashtesa më prodhimtare në formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe është prapashtesa – *shëm*, e cila është bërë mjaft prodhimtare sidomos dy dhjetëvjetëshat e fundit të shek XX. Vlen të përmendim se pothuajse prej çdo foljeje me këtë prapashtese mund të formohet një mbiemër me paranyjëzim. Rastet më të shumta të këtij lloji mbiemrash janë ata të formuar me anë të foljeve *vetvetore* – *mesore*, ku emri që cilësohet, është vetëm subjekti i veprimit, kurse objekt nuk ka, pasi folja është me kuptim jokalimtar. Këtu futen mbiemra si: *i dukshëm*, *i lëkundshëm*, *i pajtueshëm*, *i përshtatshëm*, *i shoqërueshëm* etj., që zbërthehen: *që duket*, *që lëkundet*, *që pajtohet*, *që përshtatet*, *që shoqërohet* etj.⁷

Me këtë prapashtesë janë formuar prej emrash, foljesh, ndajfoljesh, mbiemra që tregojnë një cilësi të rrjedhur të pajisur me një gjë a me një veti, p.sh.: nga *mbiemra prej foljesh*, kryesisht prej temës së pjesores, p.sh.: *i amëshueshëm* (*amëshue*), *i ardhshëm* (*ardhë*), *i besueshëm* (*besue*, *besoj*), *i gëzueshëm* (*gëzue*), *i pashëm* (*pa – më*, *pa – rë*), *i pavdekshëm* (*pa vdekë*) etj.

Me anë të kësaj prapashtese kuptimi i veprimit që ruan tema foljore prodhuese e mbiemrit ka mundësi të kryhet si psh: *i asimilueshëm*, *i besueshëm*, *i kuptueshëm*, *i pranueshëm*, *i realizueshëm*, *i përdorshëm* etj.. Po kështu edhe mbiemri *i shkëlqyeshëm* – *shkëlqej*, në kuptimin e tij të parë tregon aftësinë që ka sendi i emërtuar nga emri që cilësohet për të kryer veprimin e shprehur nga folja që shërben si temë e mbiemrit, p.sh: *lëkurë e shkëlqyeshme* = *lëkurë që shkëlqen*.

Në Fjalor gjejmë shumë mbiemra prejfoljorë të formuar me prapashtesën –*shëm*, që dalin me vlerat kuptimore të mbiemrave prejppjesorë. Ky grup paradigmatic leksemash, karakteristik për gegërishten, sot është përcaktuar dhe është orientuar për të treguar aftësinë e mundësinë e sendit të karakterizuar prej tyre për të kryer veprimin e emërtuar nga tema prodhuese, aftësinë e mundësinë, meritimin, domosdoshmërinë e pashmangshmërinë e sendit të karakterizuar prej tyre për t’iu nënshtruar veprimit të emërtuar nga tema prodhuese ose kanë kuptim veprues. Po sjellim disa mbiemra me këtë prapashtesë që në Fjalor janë barasvlerës të mbiemrave prejppjesorë, si: (*i*, *e*) *amshueshëm*, (*i*, *e*) *çmueshëm*, (*i*, *e*) *durueshëm*.

LEXUESH / ËM (i), –ME (e) *mb*. Që mund të lexohet: *shkrim* (*mbishkrim*) *i lexueshëm*.

⁶ B. Bokshi. Pjesorja e shqipes (vështrim diakronik). Prishtinë. 1998. f. 42-54.

⁷ P. Haxhillazi. Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën – *shëm* në gjuhën shqipe. S. F, 2, 1969. f. 155.

* Procesi i kalimit nga *pjesore* - *mbiemër prejpjesorë* nëpërmjet paravendosjes së nyjes është i menjëhershëm. Temë fjalëformuese tek mbiemrat prejpjesorë është folja se cilës i paravendoset nyja dhe prapavendoset pjesorja e foljes duke na dhënë një mbiemër prejpjesorë. Si formulë fjalëformimi do të kishim: N (nyje e përparme) + T.F (temë fjalëformuese, dmth pjesore) = M.P (mbiemër prejpjesorë), kështu kemi: i + laj (lahem) = i larë.

Mbiemrat prejpjesorë trashëgojnë semat kryesore kuptimore të foljeve, nga pjesoret e të cilave janë formuar, dhe lidhen drejtpërdrejt me këtë kategori gramatikore të foljeve.

* Mbiemrat prejpjesorë janë pasqyruar të procesit të gjatë të zhvillimit historik të shqipes, të periudhës parakombëtare dhe kombëtare të saj,⁸ dhe si të tillë, kuptimisht, kanë aftësinë për të shënuar tiparin e rezultatit të veprimit të shprehur nga folja që përbën temën fjalëformuese të tyre⁹, dhe kjo është veçoria themelore që i bashkon këta mbiemra në një grup të madh dhe me tipare të veçanta.

* Mbiemrat prejpjesorë ruajnë kuptimin, trashëgojnë bërthamën kuptimore të foljeve përkatëse. Kjo është më e rëndësishmja në kuptimin tyre. Foljet e gjuhës shqipe, përgjithësisht, ndahen në dy klasa të mëdha, në *folje kalimtare* dhe në *folje jokalistare*.¹⁰

Duke u mbështetur te ndarja foljeve kalimtare dhe jokalistare, foljet e shqipes kanë kategorinë e diatezës (të cilën e kanë zakonisht foljet kalimtare): *diateza veprorë, diateza pjesore, diateza vetvetore dhe diateza mesore*.¹¹

* Mbiemrat prejpjesorë formohen nga folje kalimtare, ku mundësia e realizimit është reale, dhe nga folje jokalistare ku mundësia është fiktive. Megjithatë shumë folje jokalistare kanë formuar njësi të tilla, ndërsa disa të tjera jo ose nuk e përdorin pjesoren me vlerë mbiemërore, çka kushtëzohet nga faktorë semantikë, gramatikorë, stilistikë, fjalëformues, paradigmaticë etj.; mundësitë e kalimit nga pjesorja te mbiemri tek ato është në të vërtetë fiktive, si: *mbretëruar* - **i mbretëruar*; *udhëtoj* - **i udhëtuar* etj.

* Jorgji Gjinari në dallimet dialektore midis toskërishtes dhe gegërishtes veçon se gegërishtja ka një numër relativisht të madh të mbiemrave prejpjesorë të formuar me prapashtesën – *shëm* që tregojnë mundësi ose aftësi, ndërsa toskërishtja ka në përdorim pjesoren me prapashtesat përkatëse dhe mbiemrat prejpjesorë formohen me nyjëzimin e këtyre pjesoreve, p.sh: *admiroj* – *i admiruar* - *i admirueshëm*, *punoj* – *i punuar* – *i punueshëm*, *adoptoj* – *i adoptuar* – *i adoptueshëm*.

⁸ V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999, f. 98.

⁹ V. Memisha, Dukuri semantike gjatë formimit të mbiemrave prejpjesorë në gjuhën shqipe, Gjirokastër, 1999, f. 99.

¹⁰ Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f. 265.

¹¹ Gramatika e gjuhës shqipe, 1, Tiranë, 2002, f. 270.

VEÇORI SEMANTIKE TË MBIEMRAVE PREJFOLJORË ME –SHËM NË
VEPRËN FJALORI I GJUHËS SHQIPE 2006

Shënim: Formimet me këtë lloj prapashtese të mbiemrave që dalin nga pjesorja e që janë karakteristike për gegërishten në toskërisht i përgjigjet formimi i thjeshtë me prapashtesën e pjesores, psh: *i besueshëm* – *i besuar*, *i çmueshëm* – *i çmuar*, *i lodhshëm* – *i lodhur*, *i përdorshëm* – *i përdorur*, *i rrëmbyeshëm* – *i rrëmbyer*, *i sjellshëm* – *i sjellur* etj. Në gjuhën shqipe ka disa mbiemra, të cilët motivohen nga ana semantike me lidhjen e drejtpërdrejt të kuptimeve të tyre, kryesisht me kuptimin e parë kryesor të foljes së temës prodhuese, psh: *ujë* i rrjedhshëm – rrjedh uji.

* Prapashtesa –shëm është më prodhimtarja për formimin e mbiemrave në gjuhën shqipe dhe si e tillë pothuajse prej çdo teme foljore mund të formohen mbiemra prejpjesorë me prapashtesën –shëm. Me anë të kësaj prapashtese mund të formohen mbiemra të cilat si temë fjalëformuese mund të kenë: *emër*, *ndajfolje* dhe *folje*. Mbiemrat që formohen prej temash foljore me bashkëtingëllore ose me –e, –i, apo –ye, kanë si temë fjalëformuese pjesoren pa prapashtesat –r(ë) ose –ur, p.sh: *i ndjeshëm*, *i djegshëm*, *i falshëm*, *i kapshëm*, *i mundshëm*, *i rrjedhshëm*, *i tretshëm*, *i kapërcyeshëm*, etj. Po kështu një numër i madh mbiemrash formohen edhe me prapashtesën –ueshëm nga foljet me temë në –o. Si temë fjalëformuese shërben vetë tema e foljes, duke rënë prapashtesa –o e saj, p.sh: *avulloj* – *i avullueshëm*, *i çmueshëm*, *i dëshirueshëm*, *i mrekullueshëm*, *i trishtueshëm* etj. Me këtë prapashtesë formohen edhe mbiemra me temë në –ua, p.sh: *bluaj* – *i blueshëm*, *i shkrueshëm*.¹²

Por në gjuhën shqipe ne përballemi me formime që morfologjikisht mund të jenë të rregullta, por semantikisht nuk shkojnë dhe kërkojnë zëvendësim me sinonimi leksikore a sintaksore. Në gjuhën standarde diferencimi morfemor është shoqëruar me atë semantik.

* Në qoftë se do të ndalemi te dallimet kuptimore të mbiemrave prejpjesorë: *i punuar* - *i punueshëm*, të cilët janë në sinonimi me njëri-tjetrin, atëherë do të kishim:

* PUNÛAR (i, e) mb. 1. Që është punuar a që është përpunuar: *tokë e punuar* tokë e lëvruar; *lëkurë e punuar*; *dru i punuar*; *gjuhë (vepër) e punuar*. 2. *bised.* I përdorur.

* PUNÛESH / ËM (i), -ME (e) mb. Që mund të punohet, që punohet: *tokë e punueshme*, *material i punueshëm*, *lëndë e punueshme*.

Në rastin e parë mbiemri prejpjesor tregon që veprimi ka ndodhur, ka përfunduar, pra që është punuar a që është përpunuar, ndërsa në rastin e dytë tregon për mundësinë e kryerjes së veprimit, pra që mund të punohet a që punohet. Përjasja bëhet dhe ndërmjet kuptimeve leksikore brenda së njëjtës strukturë kuptimore të mbiemrit.

* Vështrimi i kësaj lidhjeje prejardhjeje ka rëndësi parësore për të ndjekur vijën e prejardhjes kuptimore *folje* – *mbiemër prejpjesorë*.

* Sipas përkufizimit të gjuhëve neolatine kjo mënyrë e foljes u quajt **particip** pasi bën pjesë në natyrën e foljes dhe në atë të mbiemrit, p.sh: në dy fjali dallimi ndodh të gjuhët neolatine, p.sh: në frëngjisht kemi:

¹² A. Dhrimo, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe. S. F, 3, 1972, f. 61-69.

1) Është një qen që dëgjon të zonë, ku kemi foljen pjesore në të tashmen dhe në fjalinë e dytë.

2) Është një qen shumë i dëgjueshëm, kemi mbiemër prejpjesor. Në gjuhën shqipe nuk ndodh kështu, pasi në gjuhën tonë pjesorja qëndron gjithmonë në trup të foljeve dhe kur kthehet në mbiemër ajo tregon një cilësi, p.sh.: - Kam *punuar* kopshtin (pjesore) / - Një kopsht *i punuar* (mbiemër prejpjesor) / - Kopsht *i punueshëm* (mbiemër prejpjesor)

Prandaj themi se pjesorja në gjuhën shqipe tregon veprimin, gjendjen a mënyrën e të qenit një element i fjalisë dhe kur kthehet në mbiemër tregon cilësinë e këtij elementi.¹³ Në gjuhën e sotme shqipe mbiemrat prejfoljorë me prapashtesën *-shëm* janë diferencuar në mënyrë të qartë nga ana semantike. Mbiemrat me *-shëm* e bëjnë cilësimin e emrit në bazë të tiparit, aftësisë dhe mundësisë për kryerjen e veprimit.¹⁴

Në gjuhën e shkruar ende hasen formime të tilla, të cilët janë të dallueshëm mirë nga formimet e tjera mbiemërore. Për formimin e këtyre mbiemrave prejpjesorë shërben vetë tema e foljeve (pjesoreve), p.sh.: tek mbiemri *i punuar* shërben tema e foljes me *-ua*, ndërsa tek *i punueshëm* kjo temë zbërthehet në *-ue* si në toskërisht + *prapashtesën -shëm*, pra alternimi i grupit zanor *-ua* në *-ue* jep: *i punuar - i punueshëm*.

Si përfundim, në qoftë se përqasen strukturat e foljeve me strukturat e mbiemrave të krijuar prej tyre, do të vërejmë se kuptimet leksikore të secilës folje kanë të veçantën e trashëguar apo të zhvilluar, por kanë dhe të përbashkëtën për grupet e dhënë. Përpjekjet për ta pastruar shqipen nga huazimet e panevojshme nuk mund e nuk duhet të jenë të segmentuara. Procesi duhet të përfshijë gjithë vargun paradigmatic fjalëformues (folje, emër veprimi, mbiemër prejpjesor, mbiemër me *-shëm* etj.) e brenda tij mbiemrin prejpjesor.

¹³ A. Xhuvani. *Pjesoret në shqipe*. Vepra 1, f. 245.

¹⁴ P. Haxhillazi. Vëzhgime mbi mbiemrat foljorë me prapashtesën *-shëm* në gjuhën shqipe. S. F, 2, 1969. f. 152.